



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 12166 Prot

Lezhë, më 29 / 06 /2022

VENDIM

Nr. 65, Datë 28 . 06 .2022

**PËR MIRATIMIN E PBA-së 2023-2025 TË BASHKISË LEZHË (FAZA E PARË).**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit nr.68, datë 24.07.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore” dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

**Vendosi:**

- 1.Miratimin e PBA-së 2023-2025 të Bashkisë Lezhë për fazë e parë, sipas dokumentit të paraqitur të Instrumentit Planifikimit Financiar (IPF) dhe relacionit përkatës, bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
ERNEST RAKAJ

Në mungesë dhe me autorizim  
ZV/KRYETARI  
NDUE LULI





Prot 1266/  
Dt 6.7.22  
WPS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE E FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Nr. 451/5 Prot.

Lezhë, më 04.07.2022

L e n d a : Konfirmim vendimi

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

**Për djeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b; ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025”, konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 65, datë 28.06.2022 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “Për miratimin e PBA-së 2023-2025 të Bashkisë Lezhë (faza e parë)”.

